

RTV21 me 1 korik te vitit 2001 ishte l pari nder medumet, l cili u regjistrua per aplikimin e TVSH-se (tatimin mbi vleren e shtuar). Mirepo vetem pas disa muajsh, diku ne tetor te 2001, te hyrat e per gjithshme te RTV21 u reduktuan rreth 70%. Per kete ekzistojne pasqyrat finaciare te asaj kohe. Nderkohe qe RTV 21 vazhdonte t'l paguaje me rregull edhe tatimet e tjera.

Me te vleresuar se RTV21 po l veshtiresoheshin operacionet ditore dhe po i afrohej falimentimit , menagjmenti lu drejtua me nje kerkesa te shkruar Autoritetit te Administrates Tatimore, perkatesisht Z. Toni Preston udheheqes l atehershem dhe z. Ali Sadrija, zevendesit te tij , me kerkesen qe te ndeprejme aplikimin e TVSH dhe te trajtohem i njesoj ne treg si edhe mediumet e tjera te cilat nuk po e benin kete gje. Sa per shpjegim, reklamat shkonin, kryesish netelevizionin publik- RTK, ngase ata nuk aplikonin TVSH-en.

Kerkesa e RTV21 drejtuar Autoritetit te Administrates Tatimore ishte qe te ndeprejme aplikimin e TVSH qe nenkuptonte se as nuk do ta mbledhim as nuk do ta shkarkojme, pra do te jetë zero. Kerkesa konsistente qe kjo te zgjase deri ne regjistrimin e plete te mediumeve te tjera ne sistemin e TVSH-se, perkatesisht deri ne rregullimin e tregut.

RTV21 perkunder insistimit qe te marre nje per gjigje te shkruar dhe nje vendim percaktues te asaj administrate, kjo nuk ndodhi. RTV21 u udhehoq me parimin se derisa nuk ka per gjigje negative, ajo mund te vazhdoje me mosaplikimin e TVSH, deri te nje vendim tjeter te Administrates Tatimore. Nderkohe RTV21 ka paguar me rregull te gjitha tatimet e tjera per te cilat ishte e obliguar Pas konsolidimit te RTV21 dhe te tregut, ngase shumica e bizneseve tashme regjistruan veten ne TVSH, ne vitin 2004, RTV21 ne menyre vullnetare fillon te deklaroje TVSH .

Nderkohe RTV21 shperblehet me mirenjohje nga Administrata Tatimore si nje nga 10 tatimpaguesit me te mire dhe me te rregullt ne Kosove.

Perndryshe, inspektoret e Administrates Tatimore rregullisht kane percjellur afarizmin e RTV21. Nderkohe qe RTV21 ka qene ne kontakt me te gjithe Drejtoret e Administrates Tatimore , ashtu sic jane nderruar, deri tek ky l fundit . Pra te gjithe kane pasur njohuri lidhur me rastin e mosaplikimit te TVSH nga viti 2001 deri 2004.

RTV21 asnjeherë nuk ka marre ndonje verejtje prej tyre deri ne vendimin e ATK per te derguar inspektorin, l cili per disa muaj do te qendronte ne RTV 21 duke l shikuar te gjitha dokumentat ekzistuese, e te cilat jane ne posedim te RTV21 qe nga dita e themelimit.

RTV21 si kompani e cila auditohet nga auditore te jashtem per cdo vit, nuk ka pasur verejtje te cilat do te mund te kishin paralajmeruar se dikka nuk eshte ne rregull edhe ne ceshtjen tjeter te cilin do ta shpegojme me poshte.

RTV21 nuk ka zbatuar TVSH per reklamat e klienteve jasht vendit, ngase RTV21 e ka konsideruar kete si eksport. Dihet qe RTV21 por edhe TV e tjera kombetare qe nga themelimi bejne transmetime satelitore dhe I sherbejne diaspores. Edhe sipas Direktives Evropiane, qe eshte ne fuqi tashme edhe ne Kosove, pagesa e TVSH per keto raste nuk behet. Pra RTV21 ka aplikuar kete standard. Nderkohe kete standard e kane aplikuar dhe e aplikojne edhe te gjitha vendet e rajonit dhe Evropes.

ATK pas disa muajsh te punes se saj ne RTV21, ka vendosur qe ne menyre retroaktive te ndeshkoje RTV 21 per mosaplikim te TVSH-se per periudhen deri ne aplikimin e Ligjit te vet te ri, ku thuhet se nuk duhet paguar per TVSH per klientet jasht vendit. Perderisa ne Ligjin e vjetër kjo ceshtje nuk ka qene e definuar qarte dhe ka lene hapsire per interpretim. Edhe ne mungese te pervojes se ATK per veprimitari Radiotelevizive, behet interpretimi ne dem te kesaj veprimitarie, ne mungese te hapsires se vet ligjore dhe nuk merret ne konsiderate Direktiva Evropiane .

Nderkohe, pas kesaj, ATK menjehere ka zgjeruar kontrollin, perkunder Ligjit , ne te cilin thuhet se kontrolli, pos ne rastet kur nuk merr vendim te posacem vet Drejtori I ATK-se, nuk mund ta zgjeroje kontrollin ne me shume se gjashte vjet. Ligji ka hyre ne fuqi ne me 1 korrik 2011, ndersa kontrolli ka shkuar tek viti 2001. Nderkohe qe nuk ka pasur vendim me shkrim te Drejtorit te ATK-se per kete ceshtje. Sipas perfaqesuesve ligjor te RTV21, ATK ka bere shkelje te procedurave te veta.

Sa per sqarim, bizneset sipas po ketij ligji, nuk jane te obliguara qe te mbajne dokumentacionin me shume se gjashte vjet. RTV21 perkunder kesaj ka ruajtur dokumentacionin edhe pertej ketij afati dhe ne menyre transparente ia ka ofruar kete ATK-se.

Sidoqofte ATK, sipas vrojtimeve te inspektorit, ka percaktuar borxhin themelor te RTV21, I cili eshte diku rreth 700.000 Euro, nderkohe qe me zbatimin e shkalles se interesit dhe ndeshkimeve ka arritur rreth 1.800.000 Euro. RTV21 rreth 40% te te hyrave I realizon nga eksporti , nderkohe qe ne vend se te trajtohet kjo si një veprimitari pozitive qe I sjell dobi ekonomise vendore, ndodh e kunderta, ndeshkohet bisnesi.

Konform rregulloreve te ATK-se, RTV21 eshte dashur qe te filloje zbatimin e pageses, duke e riprogramuar ate ne keste mujore, ne vlere 30.145 Euro, duke filluar nga 1 Korriku 2011. RTV21 ka shfrytezuar te drejten e ankeses ne komisionin e ATK. Ky Komision e ka refuzuar ankesen , nderkohe qe ankesa ka arritur ne shkallen e dyte, qe eshte Bordi I Pavarur per Rishqyrtim . Pas seances degjimore, ne Gusht te ketij viti(2012) procedurat jane dy muajshe deri ne një perqigje e cila do te jete ne dobi te asaj pale qe ne kete rast , shpresojme te jete RTV21.

Perndryshe RTV 21 vazhdon te jete tatimpaguesi me I rregullt dhe me transparent karshi ATK-se. Kete nuk mund ta mohojne as ata ne ATK dhe kjo konfirmohet edhe nga vet ata.

Nderkohe duhet cekur se RTV 21 edhepse ka menduar se i eshte bere padrejtesi ne rastet e cekura, ka konsideruar se nuk eshte e drejte qe te perdoret mediumi per te bere presion. Kjo ngase ka konsideruar se ekzistojne shkallet e perqegjesise se njerezve te cilet jane duke u marre me rastin e saj dhe se ekzistojne format ligjore te ndjekjes se procedurave te cilat do te deshmojne ne favor te Drejtësise.

RTV21